



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i Biznesit: "ARTMOTION" SH.P.K.
Numri Unik Identifikues: 810200886
Person i autorizuar – Valon SHALA
Operator i Shpërndarjes "ARTMOTION" SH.P.K.
Platforma: OTT
Rr/Lidhja e Pejës, Zona Industriale
Prishtinë

Ref: 1908/1021/LIC/ni

VEN D I M

për licencimin e Operatorit të Shpërndarjes, "Armotion SH.P.K.", sipas platformës OTT, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj, në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01) përcakton rregullat dhe procedurat për shpërndarjen e ofruesve të shërbimeve mediale nga ana e operatorëve, pavarësisht nga teknologjia e përdorur.
3. Kandidati "Armotion SH.P.K." ka aplikuar për licencë të KPM-së, për operatorë të shpërndarjes sipas platformës OTT, më datën 15 korrik 2019.

Arsyetim

4. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin i Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.

1/3

5. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
6. Komisioni konstaton se Zyra Ekzekutive i ka ofruar kandidatit për licencë për operator të shpërndarjes “Armotion SH.P.K.” të gjitha aktet nënligjore për aplikim për licencë si: Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (Rregullorja KPM-2016/01), Rregullore për Tarifën Vjetore për Licencë (2) (KPM-2017/06), dhe Formën për aplikim për licencë të KPM-së, për operator të shpërndarjes.
7. Komisioni vlerëson se kandidati “Armotion SH.P.K.” ka paraqitur në aplikacionin e tij të gjitha të dhënat e nevojshme për licencë të KPM-së për operator të shpërndarjes në pajtueshmëri me Nenin 6 të Rregullores KPM-2016/01 dhe të shtojcës së kësaj rregullore, ku përcaktohen Procedurat, Kushtet dhe Kriteret për Licencim.
8. Me Rregulloren KPM-2016/01 nuk përcaktohet numri i kanaleve se sa duhet të përmbajë lista e pakos programore për një operator të shpërndarjes. Prandaj, Zyra Ekzekutive e KPM-se vlerëson se, një operator i shpërndarjes mund të licencohet edhe me një numër minimal të programeve të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, ndërsa, kandidati “Armotion SH.P.K.” ka dorëzuar një listë prej 183 kanaleve, si pjesë e katalogut programor.
9. Kandidati “Armotion SH.P.K.” për operator të shpërndarjes sipas platformës OTT, ka deklaruar se lista e kanaleve e propozuar për platformën OTT është e njëjtë me listën e kanaleve të cilën është duke e ofruar përmes platformës Kabllore dhe IPTV.
10. Kandidati “Armotion SH.P.K.” për operator të shpërndarjes sipas platformës OTT, përveç ofruesve të shërbimeve programore të licencuara nga KPM, të përcaktuara me nenin 9 dhe 10 të Rregullores KPM-2016/01, do të ketë të drejtë të bartë në katalogun e tij programor vetëm kanalet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën e autorit.
11. Pas pajisjes me licencë të KPM-së, kandidati për operator të shpërndarjes “Armotion SH.P.K.” mund të sigurojë marrëveshje shtesë për bartjen e programeve në platformën OTT, dhe mund të zgjerojë katalogun e programeve në të ardhmen. Kandidati “Armotion SH.P.K.” obligohet t’i ofrojë KPM-së të gjitha marrëveshjet e reja për zgjerim të listës programore, sapo t’i ketë siguruar ato.
12. Komisioni vlerëson se, kandidati “Armotion SH.P.K.” ka dorëzuar aplikacionin e tij në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara me Rregulloren KPM-2016/01 si dhe me Rregulloren e KPM-së KPM-2017/06, për t’u pajisur me licencë të KPM-së për një afat prej dhjetë (10) vitesh, me mundësi të ripërtëritjes.
13. Komisioni vlerëson se, kandidati për operator kabllor “Armotion SH.P.K.” ka përmbushur kriteret për kualifikim për t’u pajisur me licencë të KPM-së.

